



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

KUVENDI I KOMUNËS

01 Nr. 06/060/1796/2018

Datë. 07.02.2018

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2018, e mbajtur me datën 07.02.2018, me fillim në orën 10.00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi : Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Anton Shala .

Në mbledhje marrin pjesë 32 anëtarë të Kuvendit të Komunës: z. Haxhi Sejdiu, z. Nik Hyseni, z. Jusuf Osmani, z. Shaban Luma, znj. Teuta Pallaska –Milla, znj. Florentina Gjergjaj, znj. Albina Sadrija, z. Muharrem Musa, z. Faton Gutaj, znj. Dijana Qarkagjija, z. Basri Komoni, znj. Hana Zeka, znj. Edi Puka, znj. Drita Buza - Zhaveli, z. Jeton Vorfi, z. Agon Batusha, z. Shpend Komnova, znj. Mimoza Shala, znj. Lirika Komoni, z. Krishnik Alijaj, z. Bekim Jupa, z. Halit Isufi, znj. Dafina Syla, z. Bashkim Gashaj, z. Bekim Ermeni, z. Sadik Hoti, znj. Saranda Hoda, znj. Besarta Lekaj, z. Anton Shala, z. Fazli Hoxha, znj. Valentina Alijaj, z. Edmond Dushi .

Mungojnë : z. Zef Komani, znj. Arjeta Gjoklaj, z. Kreshnik Alijaj .

Të pranishëm të tjerë: Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini, Nënkryetari i Komunës z. Ramadan Hoti, Drejtoret e Drejtorive Komunale, përfaqësues të ZKKK-së, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të OSBE-së, zyrtarët për informim, zyrtarë të tjerë Komunal, si dhe përfaqësues nga mediat e shkruara dhe elektronike dhe qytetarë të Komunës së Gjakovës.

Kryesuesi: Sot do ta kemi mbledhjen e parë Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës për vitin 2018 dhe e tret me radhë për këtë vit, ju njoftoj se Kuvendi për këtë mbledhje i ka 35 anëtarë, të pranishëm në këtë mbledhje janë: 32 anëtarë, meqenëse ekziston kuorumi po fillojmë me mbledhjen

Kryesuesi : Rendin e ditës për këtë mbledhje e keni marrë së bashku me ftesën dhe me materialin e mbledhjes. Për mbledhjet e Jashtëzakonshme nuk lejohen pika të tjera të rendit të ditës andaj po fillojmë menjëherë me pikën e rendi të ditës: **Shqyrtimi i Propozimit Vendimit të Kryetarit të Komunës për ndarjen e Parcelës për ndërtimin e fushës Sintetitke .**

Propozim Vendimin e Kryetarit të Komunës së bashku me të gjitha materiet e nevojshme i keni marrë me kohë edhe në kopje Fizike dhe në kopje elektronike andaj e ftoj Kryetarin e Komunës z. Ardian Gjini që të bëjë prezantimin e kësaj pike .

Kryetari: Kjo mbledhje është thirrur e jashtëzakonshme për arsye se data 9 Shkurtë është data e fundit për dorëzimin e dokumentacioneve për me i fituar këto donacione, që janë bashkëfinancim nga Federata e Futbollit, Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit dhe Komuna. Ne kemi pasur një takim me kryetarin e federatës së Futbollit z. Vokri dhe me ministrin e Ministrisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe me kryetarët e të

gjitha komunave që kanë klube që garojnë në Super ligë që do të thotë se ky ka qenë edhe kushti për fitimin e këtij donacioni, ku ne si komunë kemi pasur për detyrë me e cakut lokacionin me e dorëzua projektin dhe kjo procedurë duhet të kalojë nëpër Kuvendin e Komunës , ne e kemi identifikuar lokacionin që është afër fushave të tenisit në një distancë të caktuar në mënyrë që edhe objektet përcjellëse të kenë hapësirën e nevojshme .

Ky është një investim i mirëseardhur për komunën e e Gjakovës që do të ju shërbej gjeneratave të ardhshëm dhe kjo zonë është ndër zonat më atraktive dhe nuk e cenon as një projekt tjetër do të ë ndërtohen edhe fushat e tenisit sepse ka pasur disa ngecje andaj shpresoj se në këtë vit do të përfundoj ky projekt. Andaj ju ftoj që ta votoni këtë projekt sepse është në të mirën e Qytetarëve të Komunës së Gjakovës .

z. Haxhi Sejdiu: Unë kamë një pyetje se kush do ta menaxhoi këtë fushë dhe kush do ta mirëmbaj, sepse ne e kemi vetëm Klubin e Vallëzimit që garon në Super ligë nëse bëhen më shumë si do të shfrytëzohet por edhe nëse mbetemi pa ekip kush do ta mirëmban.

Kryetari: Klubet që garojnë në super ligë menaxhojnë me terrenin sepse e shfrytëzojnë, dhe nëse nuk do të kemi klube atëherë komuna do ta merr menaxhimin .

z. Jeton Vorfi: Ne si Alternativë konsiderojmë se kjo ftesë është politike, dhe dëshirojmë ta shprehim mbështetjen tonë për iniciativat të tilla për ndërtimin e terreneve sportive dhe iniciativa tjera që janë në interes të Qytetarëve të Komunës së Gjakovës . Kërkojmë që edhe kërkesa dhe të gjitha procedurat të kenë bazë ligjore sepse janë disa rreziqe që paraqiten, siç janë zona e shkukzës ka një planë rregullues që është i paraqitur këtu për ndërtimin e terreneve të tenisit, dhe ky projekt për ndërtimin e fushës së futbollit nuk është në këtë plan rregullativ , andaj fillimisht ka qen dashur që ky plan të revidohet, andaj ne kërkojmë që të na njoftoi drejtori i DUMM-së se a është bërë propozimi për revidimin e këtij plani si dhe a janë ndjekur procedurat e dëgjimit publik . Nga Kryetari kërkojmë sqarime lidhur me këtë parcelë e cila është dhënë për terrene të tenisit a mendoni se është e drejtë që e njëjta parcelë ti propozohet përsëri për terrene të futbollit ministrisë .

Në prezantimin e juaj shihet se pjesa e parcelës që është propozuar për ndërtimin e fushës së Futbollit e prek pjesën e paraparë për ndërtimin e fushave të tenisit, andaj kërkojmë sqarime dhe sa i përket iniciativës për këtë fushë çdo herë do të ketë përkrahjen tonë .

Kryetari: Dokumentacionin dhe Hartën e keni dhe e shikoni se tereni i fushave të tenisit nuk preken dhe të gjithë ju jeni duke e shikuar hartën dhe e shikoni se sa është larg fusha e futbollit prej terreneve të tenisit, çështje e dytë me pas qenë i planifikuar në planin rregullativ sot kjo nuk kishte pasur nevojë që të del para jush por kishte vazhduar në pazë të planifikimit ekzistues, dhe për me i kënaqur të gjitha obligimet ligjore e kemi prezantuar sot para kuvendit për shqyrtim dhe miratim . Tani çështja është para jush se a dëshirojmë ta ndërtojmë këtë fushë apo nuk dëshirojmë, sepse vendimi është i juaji dhe janë plotësuar të gjitha kushtet.

Në fillim të fjalimit të z. Vorfit u tha se kjo mbledhje është thirr me qëllim politik , unë po ju tregoj se në fund të muajit të kaluar kanë ardhur nga Federata e Futbollit dhe nga Ministria me këtë mundësi dhe duke pasur parasysh interesin e Komunës dhe të Qytetarëve të Komunës së Gjakovës e kemi ftuar këtë mbledhje të Jashtëzakonshme për me i nxënë afatet dhe me i përfituar këto donacione dhe këtu nuk ka asgjë politike .

z. Bekim Ermeni: Sot para nesh kemi një propozim vendim i cili në vete ngërthen dy gjëra, e para është donacioni shanca që komuna ta merr këtë donacion nga Federata e futbollit dhe Ministria e Kulturës që është një rast i mirë për komunën dhe ne të gjithë të angazhohemi që të ndërtohet ky teren, pra kjo nuk diskutohet. E dyta ka të bëjë me caktimin e lokacionit se ne jemi vonë u tha edhe nga kryetari se është ardhur me vonës dhe komuna nuk është fajtorë por ne edhe sot jemi vonë për shkak se ato kritere që i ka vendosur federata ne duhet të kemi edhe lejen e ndërtimit dhe plot dokumente që duhet të kopletohen . Ky lokacion është një plan urban i miratuar nga Kuvendi i komunës dhe në atë plan pjesa për terrene sportive dhe rekreacion është i paraparë diku rreth 4.5 hektar , dhe është marrë një vendim për revidimin e planit ku është marrë një vendim i ri në të cilin janë paraparë terrenet e tenisit dhe tani jemi një situatë tjetër ku në këtë parcelë në një distancë të caktuar sipas standardeve duhet të ndërtojmë njëfish të futbollit që është në rregull por ajo që është shqetësuese

është pjesa ligjore a duhet të caktojme vendin e ndërtimit apo duhet që të bëjmë revidimin e këtij plani, sepse shqetësimi imë është mos të na kthej MAPL-ja si kundërligjorë vendimet .

Kryetari: Ne jemi konsultuar dhe pas marrjes së këtij vendimi duhet të paraqitet kërkesa për marrjen e lejes nga DKRS-ja në DUMM dhe procedura është e thjeshtë, pra fillimesh duhet të caktohet lokacioni. Për çështjen e revidimit të planit qëllimi është që të fitohen këto fonde dhe nuk kemi pasur kohë për procedura tjera dhe të gjithë e dini se ajo zonë është e paraparë për rekreacion .

z. Bekim Jupa: Grupi i PDK-së e përkrahim këtë donacion nga Federata e Futbollit dhe nga MKRS-ja gjithashtu e falënderojmë kryetarin për angazhimin e treguar për fitimin e këtij projekti që më në fund sportistët gjakovar ta kenë një fushë moderne të futbollit për realizimin e aktiviteteve të tyre, andaj kërkoj nga opozite të cilët e kanë gojën plotë në përkrahjeje të futbollit ndërsa tani kur kemi veprime konkrete paraqesin pengesa andaj ju ftoj që të votoni këtë projekt sepse është një mundësi që nuk na vije përditë në komunë dhe është në interes dhe të mirë të qytetarëve të komunës së Gjakovës .

z. Muharrem Musa: Ne e përkrahim këtë projekt dhe e mbështesim atë që u paraqit nga kryetari andaj e ftoj edhe opozitën që të mbështetë këtë projekt i cili është në të mirë të qytetarëve të Komunës së Gjakovës sidomos që ka të bëjë me realizimin e terreneve sportive që Gjakova ka nevojë edhe për disa terrere tjera të futbollit .

z. Edmond Dushi: Sa herë të kemi iniciativa për donacione që kanë të bëjë me Sporet unë i përkrahi plotësisht, dhe pajtona me atë që u tha nga z. Ermeni se duhet të respektohen procedurat ligjore gjithashtu i kam një pyetje se pjesëmarrja e Komunës prej 30.000€ a është kjo shumë vlera e tokës apo janë mjete që do të ndahen nga Buxheti i komunës .

Kryetari: Në dokumente është e shënuar se duhet të ndahet toka por edhe 30.000€ nga Buxheti i Komunës.

z. Jeton Vorfi: Ne nuk po kundërshtojmë por i gëzohemi një iniciative të tillë nga kushdo që vjen dhe do të keni përkrahjen tonë, por kemi dëshirë që ti ndjekim procedurat ligjore dhe nuk duam që një projekt i tillë të propozohet të na kthehet prapa ku kjo parcelë më herët është e tenderuar dhe është dërguar në ministri, sepse pjesa që është e propozuar për parkingun në fushën e tenisit tani po propozohet për fushën e Futbollit dhe kjo do të bije ndesh me ligjin .

znj. Mimoza Shala: Kur të ju drejtoheni opozitës jemi disa subjekte politike në opozite andaj duhet të keni kujdes që mos të na drejtoheni të gjithave me një emër .

znj. Hana Zeka: Pajtona me të gjithë parafolësit sidomos me z. Ermeni sepse ne nuk jemi për mos me e përkrah një vendim të tillë, por ne po kërkojmë shtyrjen e kësaj mbledhje për shkak të sqarimeve të procedurave ligjore sepse ne kemi një vendim që në këtë parcelë të ndërtohen fushat e tenisit që është edhe një projekt, dhe tani duam ta bëjmë një projekt të fushave të Futbollit andaj dyshimi jonë është se mos po e interferon në këtë projekt, andaj mendojmë se duhet të bëhet revidimin i këtij plani dhe të merret vendimi për këtë projekt, andaj ne kërkojmë që kjo seancë të shtyhet .

Kryetari: Kjo çka u tha është komplet politikë sepse u tha nga ju se jeni pro, vetëm për me u dëgjuar nga qytetarët që jeni pro, dhe në të njëjtën kohë po propozoni mos u realizua sepse po propozimi që të shtyhet seanca dhe të humbet afati. Të gjitha dokumentet i keni në tavolinë dhe mund të vërehet lehtë se ka hapësirë të mjaftueshme në mes të këtyre projekteve sepse ka hapësirë të mjaftueshme për të dy këto projekte .

Kryesuesi: Në këtë parcelë janë mbi 8 hektar dhe fushat e tenisit e kanë një hapësirë të caktuar dhe ka hapësirë të mjaftueshme .

Znj. Hana Zeka: Absolutisht nuk ka të bëjë me deklarime politike por për çdo projekt duhet të jetë në pajtim me planin rregullues dhe ti ndjekim procedurat ligjore .

Kryetari: Ne jemi duke i ndjekur procedurat ligjore dhe po ju them se ju e keni votuar ndërtimin e terreneve të tenisit pa pasur as projekt komplet kundër ligjit, andaj mos luani me politika që jemi pro dhe të paraqitni pengesa për mos me u realizua ky projekt shumë i rëndësishëm për qytetarët e Komunës së Gjakovës, sepse këto lojëra për mua nuk vlejnë. .

znj. Dafina Syla : Nuk është e pëlqyer kur dikush e luan avokatin e dikujt tjetër këtu , kur kemi ardhur sot në mbledhje kemi menduar se kjo pikë do të miratohet unanimisht dhe nuk do të ketë as një diskutim për arsye se këto projekte janë shumë të nevojshme për komunën tonë në mënyrë që të kontribuojmë që fëmijët tonë të largohen nga fenomenet negative. Të gjitha diskutimet e juaja ishin vetëm supozime që për mua janë hipokrizi e madhe, andaj kërkoj që të votohet ky projekt sepse është shumë i mirëseardhur .

z. Jusuf Osmani: Unë e përkrahi këtë pikë dhe mendoj se është shumë e mirëseardhur, dhe nuk ka as një pengesë por kërkohet vetëm miratimi i këtij vendimi dhe të procedohet më tutje .

z. Bekim Ermeni : Në diskutimin tim u mundova që ti ndaj këto dy gjëra, sepse unë e thash se pjesa iniciativës për ndërtimin e këtij tereni sportiv është e mirëseardhur dhe nuk është askush kundër, por pyetja ime është se a duhet të instalohet një kulturë e ndërhyrjeve në planet rregullative dhe mos të instalohet një kulturë e ndërhyrjeve në këtë mënyrë në planet rregullative .

Kryetari: Unë kamë vetëm një pyetje për juve se a dëshironi që ta miratoni këtë kërkesë apo je e ti lejmë këto instalimin e kulturave e gjëra tjera të panevojshme

z. Bekim Ermeni : Ne nuk do ta votojmë këtë projekt sepse jeni duke ndërhyrë në Planin Rregullativ.

Kryesuesi: z. Ermeni duhet ta kërkonti fjalën e mos dilni në foltore pa e kërkuar fjalën.

Kryetari: Në Komunën e Gjakovës nuk ekzistoni një plan rregullativ në të cilën figuron një fushë futbollit me rregullat e FIFA-s, pra nuk kemi as një teren të paraparë për ndërtimin e fushës dhe me qenë se tani jemi para kësaj situate që e kemi një donacion dhe duhet të gjejmë një vend të përshtatshëm dhe vendi është ky që e kemi propozuar para jush, dhe pyetja e vetme këtu është se a dëshironi ta ndërtojmë këtë fushë a jo kjo është çështja kryesore.

z. Agon Batusha: Unë nuk kamë pritur që në këtë mbledhje të krijohen krejt këto tensione për ndërtimin e fushës së Futbollit sepse të gjithë kemi dal në fushat dhe jemi takuar me sportistë dhe i kemi premtuar për përkrahje . Ne të gjithë këtu jemi për të diskutuar dhe për të ngritur dyshime, ne do ta votojmë këtë pikë por kërkojmë për të respektohen procedurat sepse në mandatin e kaluar ka pasur shumë vendime që janë kthyer , por tani për shkak të afatit kohorë duhet të shpejtojmë me procedura .

znj. Edi Puka : Ne jemi anëtar të Kuvendit dhe këtu nuk patë shumë politik por patë legjislaturë , politikë është sepse në të njëjtin vend është zvogëluar projekti për fushat e tenisit për këtë projekt të ri .

znj. Dafina Syla: Kjo që po e thoni është politikë sepse situata u sqarua shumë mirë se nuk kame afat kohor për shtyrjen e këtij projekti do të humbet ky projekt .

znj. Drita Buza: Qeveria nga projekti prej 400.000€ i ka marrë 380.000€ përkundër që kontrata për ndërtimin e terrenit të tenisit është nënshkruar, ky lokacion është i tenderuar dhe tani po hyjë edhe projekti i tjetër dhe këtë nuk do ta pranoj FIFA.

Kryesuesi: E qes në votim, miratimin e propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për caktimin e Lokacionit për ndarjen e një pjese të parcelës me sipërfaqe prej 2.0 hektar nga parcela me nr P.70705077-00107-0 në zonën kadastrale Firzë për ndërtimin e fushës së futbollit – sintetike. Kush është për Kundër dhe Abstenim

Nga Anëtarët e Pranishëm të Kuvendit të Komunës u votua kështu : 22 pro, 0 Kundër dhe 10 Abstenim . pas votimit të bërë Kuvendi e miratoj këtë :

V E N D I M

Për ndarjen e Parcelës për ndërtimin e fushës Sintetitke .

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës e miratoi vendimin për ndarjen e një pjese të parcelës me sipërfaqe prej 2.0 hektar nga parcela me nr P.70705077-00107-0 në zonën kadastrale Firzë për ndërtimin e fushës së futbollit – sintetike.
2. Pjesa e parcelës së cekur në pikën 1 të këtij Vendimi caktohet për ndërtimin e fushës së futbollit – sintetike, sipas standardeve të FIFA-së dhe UEFA-së, e cila do të shfrytëzohet nga klubet e futbollit të Komunës së Gjakovës që garojnë në Super Ligën e Kosovës.
3. Investimi për këtë projekt është i përbashkët dhe do të bëhet në baze të memorandumit të bashkëpunimit në mes të tri institucioneve: Federata e Futbollit të Kosovës do te investoj 120.000€, Ministria për Kulturë Rini dhe Sport 100.000€ si dhe Komuna e Gjakovës 30.000€.
4. Parcelës me nr. P.70705077-00107-0 në zonën kadastrale Firzë ka sipërfaqe të përgjithshme prej 81132.0 m², me vendim të Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01 Nr. 011-3733 të dt. 29.04.2014, është shpallur Interesi Publike dhe një pjesë është caktuar për ndërtimin e terreneve të tenisit në Komunën e Gjakovës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë nga nënshkrimi i kryesuesit te Kuvendit .

Kryesuesi: Ju falënderoj për pjesëmarrje dhe e shpalli të mbyllur punimin për këtë mbledhje mir u takofshim në mbledhjen e radhës.

Mbledhja u shpall e mbyllur në ora 12:30 .

Procesmbajtës

Burim Bajrami

Kryesuesi i Kuvendit

z. Anton Shala